



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:284778

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05508032

Ac.nr.2087/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit Halide Reka dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.P nga M....., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.A, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Zveçanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson D.V, avokat nga Mitrovica, për kompensimin e ushqimit-shujtave gjatë ditëve të punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1224/2019, të datës 03.03.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 26.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Zveçanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1224/2019, i datës 03.03.2022, VËRTETOHET

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1224/2019, të datës 03.03.2022, ka vendosur si në vijim: *“I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.P nga M.....,*

*II. DETYROHET e paditura Komuna e Zveçanit, që në emër të shujtave ditore për 800 ditë pune, t`ia paguajë paditësit shumën prej 1600 €, me kamatë ligjore 8% në vit nga dita e arritjes e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.*

*III. Detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia kompensojë shumën prej 394 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.”*

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën e të paditurës, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit apo ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi përmes të autorizuarit të tij, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës, me propozim që e njëjta të refuzohet e pathemeltë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me datë 05.12.2019 kundër të paditurës Komuna e Zveçanit, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë për gjithsej 800 ditë pune, për periudhën kohore 18.04.2017 deri më 11.03.2020, në shumën prej 1600 €, me kamatë ligjore 8% nga paraqitja e padisë, sipas precizimit të kërkesëpadiës në seancë gjyqësore, në pajtim me Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe precizimit të kërkesëpadiës, pas administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1224/2019, të dt. 03.03.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nga provat e administruara të cilat gjenden në shkresat e lëndës, është vërtetuar gjendja faktike, nga çka ka rezultuar se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, për faktin se nga vërtetimi nr....., i dt. 16.10.2020, kanë vërtetuar numri i ditëve të pranisë në punë, për të cilat paditësi kërkon kompensimin. Paditësi iu është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e shujtave me dt.28.10.2019. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është se a ka të drejtë paditësi në kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë. Gjykata në bazë nenit 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, ia ka aprovuar kërkesëpadinë paditësit për kompensimin e shujtave-ushqimit për ditët e pranisë në punë, sepse në bazë të kësaj dispozite paditësit i takon kompensimi për shujta ditore, edhe atë për 800 ditë pune për periudhën 18.04.2017-11.03.2020, në bazë të vërtetimit të lartcekur, ashtu për çdo ditë pune nga 2 €, në shumë të tërësishme prej

1600 €. Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës se nuk ka bazë ligjore, por që nuk arriti të provojë të kundërtën, ndërsa baza ligjore ekziston në dispozitën ligjore të Kontratës së lartcekur. Nga ana tjetër e paditura nuk arriti të provojë faktin nëse ka siguruar restorant, kuzhinë brenda saj, apo në ndonjë formë tjetër, andaj gjykata në mënyrë të padyshimtë ka vërtetuar se paditësi i cili është në marrëdhënie të punës te e paditura, ka të drejtë në kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë në shumën e cekur si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa pretendimi i të paditurës se duhet të bëhet ekspertiza financiare dhe që kontrata kolektive tani më nuk është në fuqi nuk qëndrojnë.

Për bazën juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ku përcaktohen të drejtat e të punësuarve për kompensimin për ushqim gjatë punës, lidhur me kamatën iu referuar nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendime të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku nuk është kontestues fakti që paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, ndërsa ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore prej 18.04.2017 deri me 11.03.2020, ku gjithsej i ka 800 ditë pune, në shumë prej 1600 € (çdo ditë nga 2 €) e ka vërtetuar në bazë të vërtetimit nr. 1/69/2020, i dt. 16.10.2020

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se: Me nenin 90 par. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në*

*formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Ndërsa nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se: *“ Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimi për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë formë tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Andaj edhe për vlerën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, me të drejtë iu është njohur shuma totale prej 1600 €.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9.”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës ditore) gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se e paditura nuk ka për detyrim të paguajë shpenzimet e ushqimit, pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e këtyre kontratave me ç‘rast të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunitat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo-arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit bie mbi të paditurën e cila është e detyruar ta përmbushë një detyrim të tillë, andaj edhe një pretendim i tillë del të jetë i pathemeltë të cilin gjykata ankimore vendosi ta refuzojë.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka refuzuar të pathemeltë pretendimin ankimor se lidhur me vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë, duhet ekspertizë financiare, për arsye se dispozita e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive qartë thekson se për çdo ditë të pranisë në punë kompensimi i ushqimit është 2 €, andaj ekspertiza financiare nuk është e nevojshme, sepse për 800 ditë të pranisë në punë, për çdo ditë nga 2 €, qartë rezulton se shuma totale është 1600 €.

Gjykata e Apelit vlerëson se kamata është gjykuar drejtë në pajtim me nenin 382 të LPK-së, si dhe shpenzimet e procedurës janë gjykuar drejtë, në pajtim me veprimet e ndërmarra procedurale dhe dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i mori parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2087/2022, me datë 26.03.2024

Kryetare e kolegjit  
Nora Bllaca Dula, d.v.